

# Ligj për veprimtarinë hulumtuese - shkencore

TEKST I KONSOLIDUAR ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 147/2013, 41/2014, 145/2015, 154/2015, 30/2015 dhe 53/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/2020, 163/2021, 64/2024 dhe 235/2024).

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen parimet, qëllimet, interesi publik, realizimi i veprimtarisë hulumtuese-shkencore, subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe mënyra e financimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Me këtë ligj përcaktohen edhe subjektet e organizimit dhe të administrimit me veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe kushtet për kryerjen e kësaj veprimtarie.

### Nocionet

### Neni 2

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. "**Veprimtaria hulumtuese-shkencore**" i përfshin hulumtimet fundamentale dhe të zbatueshme, rezultatet e të cilave përmbajnë burim/origjinalitet, ndërsa janë të drejtuara ndaj zgjerimit dhe avancimit të veprimtarisë dhe të njohurive të përgjithshme;
2. "**Hulumtime (të zbatueshme) aplikative**" përfshijnë bartjen e njohurive për përmirësimin e teknologjive ekzistuese dhe vendosjen e teknologjive të reja, si dhe zbatimin e atyre njohurive në gjetjen e zgjidhjeve praktike për zhvillimin e ekonomisë.
3. "**Institucione arsimore sipërore**" janë universiteti dhe shkolla e lartë profesionale;
4. "**Universitet shtetëror**" është institucioni publik i themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në bazë të ligjit për realizimin e interesit publik në veprimtarinë arsimore dhe hulumtuese-shkencore;
5. "**Universitet privat**" është institucioni i themeluar nga personi juridik ose fizik për realizimin e veprimtarisë arsimore dhe hulumtuese-shkencore;

6. "**Institucion i pavarur shtetëror i arsimit shtetëror sipëror**" është institucioni publik i cili kryen veprimtari arsimore të ciklit të parë në kohëzgjatje së paku prej tre vjetësh dhe arsimit të ciklit të dytë të arsimit special në kohëzgjatje së paku prej një viti, dhe i cili zbaton hulumtime zhvillimore dhe hulumtime të zbatueshme;

7. "**Institucion i pavarur privat i arsimit sipëror**" është institucioni publik i themeluar nga personi vendës ose i huaj juridik ose fizik i cili kryen veprimtari arsimore të ciklit të parë në kohëzgjatje së paku prej tre vjetësh dhe arsimit të ciklit të dytë të arsimit special në kohëzgjatje së paku një viti, dhe i cili zbaton hulumtime zhvillimore dhe të zbatueshme;

8. "**Institucion shkencor publik**" është institucioni i pavarur shkencor, i themeluar me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili kryen veprimtari me interes të lartë strategjik dhe nacional për Republikën e Maqedonisë së Veriut;

9. "**Institucion shkencor i përzier**" është institucioni i themeluar nga Republika e Maqedonisë së Veriut nga njëra anë dhe nga person i huaj ose vendës juridik ose fizik, nga ana tjetër;

10. "**Institucion shkencor privat**" është institucioni i themeluar nga personi vendës ose i huaj;

11. "**Hulumtues**" është personi fizik i cili kryhen veprimtari hulumtuese-shkencore dhe hulumtime shkencore në subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore;

12. "**Udhëheqës i projektit**" është hulumtuesi i cili udhëheq me projektet hulumtuese-shkencore;

13. "**Hulumtues i pavarur**" është personi fizik i cili në mënyrë të pavarur kryhen veprimtari hulumtuese-shkencore në pajtim me këtë ligj dhe

14. "**Infrastrukturë hulumtuese-shkencore**" janë objektet, laboratorët dhe stacionet provuese, qendrat e inovacionit, qendrat përllogaritëse, pajisja shkencore, qendrat bibliotekare-informative dhe referuese, dokumentacioni arkivor dhe botues, si dhe gjithçka tjetër që kontribuon për hulumtime shkencore.

## II. PARIMET NË VEPRIMTARINË HULUMTUESE-SHKENCORE

### Neni 3

Veprimtaria hulumtuese-shkencore themelohet në bazë të parimeve, si vijon:

- liria dhe autonomia e hulumtimeve dhe krijimtarisë,
- lidhshmëria me sistemin arsimor,

- etika,
- transparencë në punën dhe disimilimin e rezultateve,
- aplikimi i standardeve ndërkombëtare të kualitetit në shkencë,
- pacenueshmëria dhe mbrojtja e personalitetit dhe të dinjitetit të njeriut,
- llojllojshmëria e mendimeve, teorive dhe doktrinae,
- zbatimi i standardeve evropiane për regrutimin e hulumtuesve dhe sjelljes së tyre,
- konkurrenca dhe barazia e mundësive,
- mbrojtja e pronësisë intelektuale dhe
- zbatimi i rezultateve.

### III. QËLLIMET E LIGJIT

#### Neni 4

Me vendosjen e organizimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe përcaktimin e financimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, sigurohet:

- avancimi në vazhdimësi i veprimtarisë hulumtuese-shkencore,
- lidhshmëria e ndërsjellë e shkencës dhe arsimit,
- koordinimi i subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore,
- avancimi i bashkëpunimit vendës dhe ndërkombëtar në bartjen e diturive, kërkim, trajnim dhe aplikim,
- përparimin e shfrytëzimit të rezultateve nga hulumtimet,
- transparencë në hulumtimet dhe në përdorimin e rezultateve,
- rritja e produktivitetit të punës dhe e aftësisë nacionale konkurruese në hapësirën globale,
- rritja e kualitetit individual dhe shoqëror të jetesës,
- barazia e grave në shkencë,
- zhvillimi i barabartë regional i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- afirmimi i identitetit nacional dhe
- zhvillimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

### IV. INTERESI PUBLIK

#### Neni 5

Interes publik në veprimtarinë hulumtuese-shkencore paraqesin hulumtimet, të cilat janë:

- kontribut për zhvillimin e mendimit shkencor dhe ngritjen e nivelit shkencor në të gjitha sferat, fushat dhe lëmenjtë e shkencës,
- kontribut për transferimin e njohurive, teknologjive dhe shkathtësive botërore,
- kusht i përgjithshëm për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- nga sfera e identitetit historik dhe kulturor të popullit maqedonas, si dhe të qytetarëve që

jetojnë brenda kufijve të saj, e që janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- prezantim të rezultateve të arritura shkencore në botë dhe te ne dhe
- nga sfera e mbrojtjes dhe sigurisë.

Interes publik në veprimtarinë hulumtuese-shkencore paraqet edhe aftësimi dhe përsosja e kuadrove për punën hulumtuese-shkencore, si dhe përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës hulumtuese-shkencore, e cila është në funksion të realizimit të hulumtimeve nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **V. REALIZIMI I VEPRIMTARISË**

### **Programi nacional për arsim të lartë dhe veprimtari hulumtuese shkencore i Republikës së Maqedonisë së Veriut**

#### **Neni 6**

Programi nacional për arsim të lartë dhe veprimtari hulumtuese shkencore i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Programi nacional) del nga dokumentet strategjike zhvillimore nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me programin nacional rregullohen drejtimet zhvillimore dhe prioritetet për financim në veprimtarinë hulumtuese-shkencore.

Në programin nacional përcaktohen bazat fillestare, qëllimet, përmbajta dhe vëllimi i detyrave në sferën e shkencës, mënyra e koordinimit dhe zbatimit të saj, infrastruktura e nevojshme hulumtuese, mënyra e financimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, projekte për nevojat e kuadrove për shkencë dhe treguesit për përcjelljen e efikasitetit të realizimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, dimensiononi ndërkombëtar, lidhshmëria me ekonominë dhe me rrjetin institucional.

Programi nacional është bazë për orientimin dhe përcaktimin e vëllimit të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Programi nacional realizohet me kryerjen e hulumtimeve fundamentale, hulumtimeve të zbatuara, bartjen e njohurive dhe aktivitete të tjera në sferën e hulumtimeve shkencore dhe të zhvillimit.

Programi nacional realizohet përmes programeve vjetore.

## **Neni 7**

Programin nacional e realizojnë subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

## **Neni 8**

Programin nacional e miraton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Qeveria) për periudhë prej katër vitesh, me mendim paraprak të Këshillit Nacional për Arsim të Lartë, Shkencë, Inovacione dhe Teknologji (në tekstin e mëtejme: Këshilli Nacional), ASHAM-it dhe Konferencës Ndëruniversitare.

Qeveria, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në dy vjet i dorëzon raport për zbatimin e programit dhe për gjendjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Për realizimin e Programit nacional është përgjegjës ministri kompetent për punët e shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri)

**Komiteti nacional për zhvillimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe zhvillim teknologjik në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

## **Neni 9**

*I fshirë*

**Përbërja dhe zgjedhja e Komitetit nacional për zhvillim**

*I fshirë*

**Këshilli për veprimtari hulumtuese-shkencore**

## **Neni 11**

*I fshirë*

## **Neni 12**

*I fshirë*

**Trupat profesionalë**

## **Neni 13**

Për ndihmë profesionale gjatë marrjes së vendimeve dhe zbatimit të politikës hulumtuese-shkencore dhe zhvillimore, ministri mund të formojë trupa profesionalë.

## **Këshilli për etikë**

### **Neni 14**

Qeveria i emëron anëtarët e Këshillit për etikë (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli).

Këshilli numëron nëntë anëtarë, nga të cilët gjashtë janë hulumtues të propozuar nga Konferenca ndëruniversitare, ndërsa tre anëtarë të propozuar nga AMSHA. Gjatë emërimit të anëtarëve të Këshillit zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive dhe respektohen kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës.

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat katër vjet.

Këshilli ka kryetar dhe zëvendëskryetar, të zgjedhur nga radhët e anëtarëve.

Detyrë e Këshillit është përcjellja dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve etike dhe vlerave në veprimtarinë hulumtuese-shkencore, mbrojtjen e integritetit njerëzor në hulumtimet shkencore dhe etike në raportet afariste ndërmjet subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Këshilli miraton kodeks etik me të cilin përcaktohen parimet etike: në punën hulumtuese-shkencore; gjatë shpalljes së rezultateve të veprimtarisë hulumtuese-shkencore; në raportet ndërmjet hulumtuesve; në procedurat dhe veprimtaritë e lidhura me konkurrencën dhe në raportet me publikun dhe me mjetet e informimit publik.

Këshilli miraton rregullore për punë.

Mendimet dhe qëndrimet e veta Këshilli i miraton në formë të rekomandimeve.

Së paku një herë në vit Këshilli i paraqet raport për punën e vet Qeverisë.

Subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, në pajtim me aktet e tyre, mund të themelojnë këshilla për etikë dhe të miratojnë kodekset e veta etike.

## **VI. SUBJEKTE PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE HULUMTUESE-SHKENCORE**

### **Neni 15**

Subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore janë: universiteti shtetëror dhe universiteti privat - në njësitë e tyre të drejtuara ndaj shkencës (institucionet shkencore) dhe në njësi të drejtuara ndaj arsimit të bazuar në shkencë (fakultete); AMSHA; institucioni i pavarur shtetëror-arsimor sipëror; institucioni i pavarur privat arsimor sipëror; institucioni publik shkencor; institucioni i përzier shkencor; institucioni privat shkencor, dhe hulumtues i pavarur.

## **Institucioni publik shkencor**

### **Neni 16**

Institucion publik shkencor mund të themelojë Qeveria me mjete të pronësisë shtetërore si shtetëror (institucion nacional) në pajtim me kriteret e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

Institucioni shkencor publik mund të themelohet nëse:

- ka program në të cilin janë përcaktuar lëmenjtë e hulumtimeve shkencore,
- janë siguruar hapësira përkatëse dhe pajisje për realizimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe profesionale, dhe
- është siguruar numri i personave të nevojshëm të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zgjedhje në tituj shkencorë edhe atë së paku gjashtë hulumtues, prej të cilëve tre me doktoratë shkencë dhe tre me magjistraturë.

## **Institucioni i përzier shkencor**

### **Neni 17**

Institucion të përzier shkencor mund të themelojë Republika e Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit, komuna me person vendës ose të huaj juridik ose fizik (bashkëthemelues), me mjete nga buxhetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qytetit të Shkupit dhe të komunës, nga njëra anë dhe me mjete personale të personit juridik ose fizik të huaj ose të vendit nga ana tjetër.

Bashkëthemeluesit e institucionit të përzier shkencor fitojnë pjesëmarrje themeluese në institucion në pajtim me mjetet e investuara.

Institucioni i përzier shkencor mund të themelohet nëse janë plotësuar kushtet si vijon:

- ka program në të cilin janë përcaktuar lëmenjtë e hulumtimeve shkencore,
- ka në marrëdhënie pune së paku pesë hulumtues nga të cilët tre janë me doktoratë të shkencave dhe dy me magjistraturë,
- veprimtaria hulumtuese-shkencore është veprimtari e saj kryesore, dhe
- ka siguruar mjete të nevojshme, pajisje dhe hapësirë për punë.

## **Institucioni privat shkencor**

### **Neni 18**

Institucioni privat shkencor mund të themelohet nga personi vendës ose i huaj juridik ose fizik (themelues), me mjete në pronësi private.

Institucioni privat shkencor mund të kryejë veprimtari hulumtuese-shkencore nëse janë plotësuar kushtet si vijon:

- ka program në të cilin janë përcaktuar lëmenjtë e hulumtimeve shkencore,
- ka në marrëdhënie pune së paku pesë hulumtues nga të cilët dy janë me doktoratë të shkencave dhe tre me magjistraturë ose, së paku me arsim sipëror,
- veprimtaria hulumtuese-shkencore është veprimtaria e saj kryesore; dhe
- janë siguruar mjete të nevojshme, pajisje dhe hapësirë për punë.

Përgatitjet për fillimin me punë të institucionit privat shkencor i kryhen themeluesi në mënyrën e paraparë me aktin për themelim.

### **Neni 19**

Përgatitjet për fillimin me punë të institucioneve shkencore i kryen komisioni të cilin e formon Qeveria.

Komisionin e përbëjnë pesë anëtarë me tituj shkencorë ose arsimorë shkencorë nga sfera shkencore në të cilën themelohet institucioni.

Komisioni bën zgjedhje në tituj shkencorë, vendos për themelimin e marrëdhënies së punës, miraton program për punë, miraton Statut të përkohshëm dhe kryhen detyra të tjera të drejtpërdrejta për fillimin me punë të institucionit.

Komisioni pushon me punë pasi do t'i kryejë detyrat e parapara nga paragrafi 1 i këtij neni, e më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga formimi i tij.

### **Neni 20**

Institucionet shkencore mund të jenë anëtare të universitetit.

### **Neni 21**

Administrimi, udhëheqja dhe kompetencat e organeve në institucionin shkencor publik, institucionin e përzier shkencor dhe në institucionin privat shkencor, rregullohen me aktin për themelim dhe Statutin e institucionit, në pajtim me dispozitat nga ligji për institucionet dhe me këtë ligj.



Pajtim për Statutin e institucionit publik shkencor jep Qeveria.

Pajtim për Statutin e institucionit të përzier shkencor japin bashkëthemeluesit.

Pajtim për Statutin e institucionit privat shkencor jep themeluesi.

## **Hulumtuesi i pavarur**

### **Neni 22**

Hulumtuesi i pavarur mund të kryejë veprimtari hulumtuese-shkencore nëse, përveç kushteve të përgjithshme për kryerjen e veprimtarisë i plotëson edhe kushtet si vijon:

- ka doktoratë të shkencave,
- ka program në të cilin janë përcaktuar lëmenjtë e hulumtimeve shkencore,
- kryen hulumtime shkencore në pesë vitet e ardhshme,
- ka së paku pesë punime shkencore nga sfera përkatëse të botuara në revista shkencore, dhe
- ka siguruar mjete të nevojshme, pajisje dhe hapësirë për kryerjen hulumtimeve shkencore.

## **Qendra shkencore e veçantë**

### **Neni 23**

Qendër shkencore e veçantë është institucioni shkencor ose grup hulumtuesish e cila sipas origjinalitetit, rëndësisë dhe aktualitetit të vet të rezultateve të arritura në veprimtarinë hulumtuese-shkencore bën pjesë në radhën e institucioneve ose grupeve më cilësore të hulumtuesve në botë në kornizat e sferës së vet shkencore.

Qendra shkencore e veçantë doemos duhet që në punën e vet të ketë realizuar: lidhshmëri të fortë ndërmjet diturisë, hulumtimit dhe inovacionit, përkatësisht lidhje të ngushtë ndërmjet hulumtimit dhe biznesit; program hulumtues të fokusuar i cili përfshin tema interdisiplinore, realizime të zbatueshme dhe bazike; të ketë kapacitet të sigurojë atmosferë pune dinamike, fleksibile dhe atraktive e cila kontribuon për arritje të larta në nivelin individual dhe kolektiv; mekanizma për ngritjen e gjeneratave të reja me talent shkencor-teknologjik; si dhe aftësi për realizimin e raportit dinamik të partneritetit me organet shtetërore dhe njësit të vetadministrimit lokal.

Kriteret e veçanta për shpallje dhe evaluim të jashtëm të Qendrave Shkencore të Përkryerjes, në bazë të standardeve ndërkombëtare, me propozim të Këshillit Nacional, i përcakton ministri.

Qendrën shkencore të veçantë e shpall ministri me propozimin e Këshillit Nacional, në pajtim me institucionet shkencore të kandiduar ose grupe hulumtuesish, në bazë të plotësimit të kriterëve nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, vlerësimeve nga neni 47 dhe 48 të këtij ligji dhe procedurën e cila detyrimisht përfshin vlerësimin ndërkombëtar.

Qendra shkencore e veçantë është subjekt i monitorimit të vazhdueshëm dhe evaluacion periodik i pavarur i jashtëm që të sigurojë kualitet më të lartë të rezultateve dhe shfrytëzim më efikas të resurseve. Evaluacioni i pavarur i jashtëm do të hulumtojë se si qendra hulumtuese e veçantë e plotëson qëllimin e vet, përkatësisht efektivitetin e vet, mirëmbajtjen, efikasitetin dhe relevancën e aktiviteteve me qëllimet e përcaktuara në Programin nacional. Rezultatet nga evaluacioni do të shpallen në mënyrë transparente.

Qendra shkencore e veçantë shpallet në një periudhë prej tre vjetësh. Pas skadimit të periudhës prej tre vjetësh, në bazë të vlerësimit të ri, përsëri mund të shpallet për qendër shkencore të veçantë për tre vjet.

#### **Neni 24**

Për aktivitetet plotësuese të qendrave shkencore të veçanta sigurohen mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **VII. VEPRIMTARIA HULUMTUESE-SHKENCORE E INSTITUCIONEVE ARSIMORE SIPËRORE**

#### **Neni 25**

Institucionet arsimore sipërore kryejnë hulumtime fundamentale, zhvillimore dhe hulumtim të zbatueshëm dhe veprimtari tjera krijuese në mënyrë të përcaktuar me Statutin e institucionit, në pajtim me qëllimet specifike të institucionit.

Veprimtaria e hulumtimit shkencor dhe zhvillimit e cila bëhet në institucionet arsimore sipërore ka për qëllim dhe ngritjen e kualitetit të arsimit. Institucioni studentëve u siguron kushte për fitimin e aftësive dhe shkathtësive për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore (aftësi metodologjike), jep mundësi në vazhdimësi për plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike bashkëkohore, kujdeset për përmirësimin e kualifikimit të personelit akademik, për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me institucionet e afërta arsimore sipërore dhe shkencore, për organizimin e tubimeve shkencore, simpoziumeve, këshillimeve dhe llojeve të tjera të tubimeve, shkëmbimit të shërbimeve shkencore dhe profesionale dhe prodhimeve të personave fizikë dhe juridikë vendës ose të huaj, si dhe krijon mjete materiale për zhvillim dhe punë në institucion.

Kuadri akademik ka të drejtë të kryejë veprimtari hulumtuese-shkencore dhe jashtë programit vjetor të institucionit me kusht të plotësimit të detyrimeve ndaj institucionit në pajtim me marrëveshjen për punë.

Me Statutin e institucionit rregullohen kushtet për realizimin e veprimtarisë nga ky nen.

## **Neni 26**

Veprimtaritë hulumtuese-shkencore dhe zhvillimore në institucionet arsimore sipërore, të përcaktuara në programin vjetor për veprimtari hulumtuese-shkencore të institucionit, doemos duhet të sigurojnë lidhjen e mësimit dhe hulumtimit shkencor në një apo më tepër disiplina të afërta, përkatësish të lidhura në mënyrë reciproke shkencore dhe profesionale dhe të kujdesen për zhvillimin e tyre.

Planifikimi programit vjetor për veprimtari hulumtuese-shkencore të institucioneve arsimore sipërore përcaktohet në bazë të nevojave për zhvillimin e tokës, rëndësinë e hulumtimit shkencor për arsimin e studentëve, aftësimin e personalit akademik, mjetet financiare në dispozicion, e në pajtim me standardet, normativat dhe rregullat për organizimin dhe kryerjen e veprimtarisë arsimore sipërore dhe hulumtuese-shkencore të rregulluara me Ligjin për arsimin sipëror.

Institucionet arsimore sipërore kryejnë shërbime të ndryshme profesionale, si ekspertizë, analizë, këshillim, monitorim, shërbime klinike, shërbime informative dhe ngjashëm, të cilat rregullohen me statutet dhe rregulloret e tyre. Këto veprimtari kryhen me financimin e palëve të interesuara. Të ardhurat nga këto veprimtari janë të ardhura personale të institucionit. Institucioni, për shkak të motivimit të hulumtuesve dhe personelit tjetër, një pjesë nga këto të ardhura mund t'i përdorë për shpërblim në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore të institucionit.

## **Neni 27**

Planifikimi i veprimtarisë hulumtuese-shkencore i përfshin edhe programet studimore nga cikli i tretë - studime doktorature dhe të njëjtët duhen të jenë pjesë përbërëse e programeve vjetore.

## **Neni 28**

Institucioni arsimor sipëror, në interes të ngritjes së kualitetit të veprimtarive hulumtuese-shkencore dhe zhvillimore të procesit mësimor, si dhe zhvillimit të papenguar të veprimtarive hulumtuese-shkencore, mund të formojë shoqëri ose fondacione dhe të investojë në to në pajtim me këtë ligj, Ligjin për arsimin sipëror dhe aktet nënligjore.

## VIII. ORGANET E ADMINISTRIMIT

### Neni 29

Organet e administrimit të institutit shkencor si njësi e institucionit publik dhe privat arsimor sipëror, institucionit publik shkencor, institucionit të përzier shkencor dhe institucionit privat shkencor janë: Këshilli dhe drejtori.

### Neni 30

Këshillin e institucionit publik shkencor e përbëjnë nëntë anëtarë nga të cilët gjashtë janë përfaqësues të të punësuarve në institucion dhe tre përfaqësues të cilët i përcakton Qeveria.

Mënyrën e zgjedhjes dhe të shkarkimit të përfaqësuesve të të punësuarve në Këshillin e institucionit publik shkencor përcaktohet me statutin e institucionit, me atë që së paku tre përfaqësues janë me titullin doktorë shkence.

Anëtarët e Këshillit të institucionit publik shkencor zgjidhen në kohë prej katër vjetësh.

### Neni 31

Këshilli i institucionit publik shkencor:

- miraton statutin,
- miraton programin për punë dhe zhvillim,
- merr vendim për themelimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë;
- miraton planin financiar,
- miraton llogarinë vjetore;
- zgjedh dhe shkarkon drejtorin,
- miraton akte për sigurimin dhe kontrollin e brendshëm të kualitetit të veprimtarisë shkencore dhe hulumtuese-shkencore dhe e përcjell zbatimin e tyre,
- kryen zgjedhjen dhe rizgjedhjen në tituj shkencorë,
- vendos për paraqitjen e projekteve hulumtuese-shkencore dhe për botimin e punëve shkencore,
- miraton raporte për realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore,
- vendos për organizimin e tubimeve shkencore, simpoziumeve dhe të ngjashme,
- vendos për punët të cilat kanë të bëjnë me aftësimin dhe përsosjen e kuadrove hulumtuese-shkencore,
- vendos për punët të cilat kanë të bëjnë me furnizimin e literaturës shkencore dhe pajisje,
- vendos për punët në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar shkencor;
- miraton raportin vjetor për punë, dhe
- kryen punë të tjera të cilat janë në funksion të realizimit të veprimtarisë.

## Neni 32

Në vendosjen për çështjet nga neni 31 alineja 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 13 të këtij ligji, përveç përfaqësuesve të të punësuarve, marrin pjesë edhe përfaqësuesit të cilët i cakton Qeveria.

Vendimet për çështjet nga paragrafi 1 të këtij neni konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar shumica nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të të punësuarve dhe shumica e përfaqësuesve të cilët i përcakton Qeveria.

Në vendosjen për çështjet nga neni 31 alineja 8 i këtij ligji marrin pjesë përfaqësues të të punësuarve me tituj shkencorë, ndërsa vendimet për këto çështje konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar shumica nga këta përfaqësues.

Në vendosjen për çështjet nga neni 31 alinetë 7, 9, 10, 11, 12, 14 dhe 16 të këtij ligji, marrin pjesë përfaqësues të të punësuarve, ndërsa vendimet për këto çështje konsiderohen të miratuara nëse për to kanë votuar shumica nga këta përfaqësues.

## Neni 33

Për drejtor të institucionit publik shkencor mund të zgjidhet personi me titull shkencor, përkatësisht mësimitor-shkencor i cili i plotëson dhe kushtet e tjera të përcaktuara në statutin e institucionit.

Drejtori zgjidhet me konkurs publik në një kohë prej katër vjetësh.

Drejtori i institucionit shkencor publik zgjidhet në bazë të propozimit të komisionit konkurrues që e formon këshillin e institucionit.

Komisioni konkurrues përbëhet nga pesë anëtarë nga të punësuarit në institucionin shkencor publik prej të cilëve tre anëtarë janë me tituj shkencorë.

Drejtori i institucionit shkencor publik e përfaqëson dhe prezanton institucionin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së institucionit.

Drejtori i institucionit shkencor publik e propozon programin për punë dhe zhvillim dhe ndërmerr masa për zbatimin e tij, i zbaton vendimet e këshillit, e propozon organizimin e institucionit, i emëron dhe shkarkon personat përgjegjës në institucion, vendos për shpërndarjen e të punësuarve në punë të caktuara dhe detyra dhe kryen punë të tjera të parapara me ligj dhe me Statutin e institucionit.

Drejtori i institucionit shkencor publik mund të heqë nga zbatimi vendim të marrë nga këshilli, nëse konsiderohet se vendimi i tillë është në kundërshtim me ligjin ose me akt tjetër.

Për veprimin nga paragrafi 7 i këtij neni drejtori e njofton Ministrinë.

#### **Neni 34**

Pajtim për vendimin për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit të institucionit shkencor publik jep Qeveria.

### **IX. HULUMTUESIT**

#### **Hulumtuesit**

#### **Neni 35**

Hulumtuesit në subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore zgjidhën në tituj shkencorë.

Tituj shkencorë janë: bashkëpunëtor shkencor, bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe këshilltar shkencor.

#### **Neni 36**

Bashkëpunëtor shkencor mund të jetë personi i cili ka shkallë shkencore doktor i shkencave nga sfera për të cilën zgjidhet, punime shkencore të botuara, përkatësisht arritje në zbatimin rezultateve hulumtuese-shkencore.

Bashkëpunëtor shkencor i lartë mund të jetë personi i cili ka titull shkencorë doktor i shkencës nga sfera për të cilën zgjidhet, më shumë punime shkencore të recensuara të botuara në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me autorë të tjerë, pjesëmarrje në projekte hulumtuese shkencore dhe ka arritje të rëndësishme në zbatimin e rezultateve hulumtuese-shkencore dhe kontribut në aftësimin e kuadrove hulumtuese-shkencore.

Këshilltar shkencor mund të jetë personi i cili ka titull shkencor doktor i shkencës nga sfera për të cilën zgjidhet, më shumë punime shkencore të recensuara të botuara në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me autorë të tjerë të cilat kanë ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e shkencës dhe praktikës, të ketë qenë hulumtues kryesor ose ka kontribut të rëndësishëm në realizimin e programeve dhe të projekteve dhe në aftësimin e kuadrove hulumtuese-shkencore.

Gjatë zgjedhjes ose rizgjedhjes në titullin më të lartë, përkatësisht titullin shkencor merren parasysh punime shkencore të botuara në revista shkencore, monografi, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, konferenca dhe tubime, rezultatet e arritura dhe kontributi në krijimin e kuadrove të reja hulumtuese-shkencore në kohën e zgjedhjes së fundit.

Hulumtuesit në institucionin publik shkencor i cili do të publikojë punë shkencore ose profesionale në revistat më prestigjioze ndërkombëtare me impakt faktorë, i rritet rroga në tre vitet e ardhshme për 20% nga paga që e ka pranuar.

Mënyrën e rritjes së pagës nga paragrafi 5 i këtij neni e përcakton ministri.

### **Neni 37**

#### *I fshirë*

### **Procedura për zgjedhje**

### **Neni 38**

Zgjedhja e kandidatëve në tituj shkencorë, kryhet me konkurs publik që e shpall subjekti i veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Konkursi shpallet për të gjithë titujt shkencorë.

Arritja e titullit shkencor të hulumtuesve të zgjedhur është graduale.

Gjatë zgjedhjes së kandidatëve nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen dispozitat nga nenet 36 dhe 37 të këtij ligji.

Procedura për zgjedhje mund të zgjatë së paku gjashtë muaj. Nëse ajo nuk kryhet në këtë afat, procedura ndërpritet dhe shpallet konkurs i ri.

### **Neni 39**

Zgjedhjen e kandidatëve në tituj shkencorë e kryen Këshilli, në bazë të vlerësimit të komisionit të recensionit të cilin ai e formon pas mbarimit të afatit për paraqitjen e kandidatëve.

Anëtarët e komisionit të recensionit zgjidhen nga radhët e personave me tituj hulumtues dhe mësimorë shkencorë nga institucioni i njëjtë arsimor sipëror ose tjetër, përkatësisht institucioni shkencor.

Komisioni i recensionit përbëhet prej së paku tre anëtarësh nga të cilët më tepër se gjysma janë persona me tituj hulumtues dhe mësimorë-shkencorë nga lëmi i njëjtë shkencor në sferën shkencore ku zgjidhet kandidati, ndërsa anëtarët e tjerë janë nga sfera përkatëse shkencore.

Anëtarët e komisionit të recensionit nuk mundën të jenë në tituj më të ulët nga titulli në të cilin zgjidhet kandidati.

Mbi principin e reciprocitetit, anëtari i komisionit të recensionit, nën kushtet e njëjta të përcaktuara të këtij ligji, mund të jetë edhe personi me titull shkencor nga institucion i lartë arsimor i akredituar, përkatësisht institucioni shkencor jashtë vendit me të cilin subjekti e veprimtarisë hulumtuese-shkencore ka të lidhur marrëveshje për bashkëpunim reciprok.

Për të gjithë kandidatët e paraqitur komisioni i recensionit dorëzon raport në formë të shkruar në afatin e përcaktuar me aktin për formimin e tij.

Raporti nga paragrafi 6 i këtij neni përmban të dhëna biografike për kandidatin, pasqyrën dhe vlerësimin e punës së tij profesionale dhe vlerësimin e plotësimit të kushteve për zgjedhje në titull shkencor, përkatësisht bashkëpunëtor.

Subjekti i veprimtarisë hulumtuese-shkencore që bën zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje, është i detyruar ta shpallë raportin e komisionit të recensionit në buletin përkatës dhe në ueb faqen e subjektit më së voni 15 ditë para ditës së zgjedhjes.

Procedura për zgjedhje në tituj shkencorë për së afërmi rregullohet me Statutin e subjektit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore në pajtim me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në tituj mësimorë-shkencorë, shkencorë, mësimorë të miratuar nga subjekti i veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

## **Themelimi i marrëdhënies së punës**

### **Neni 40**

Personat e zgjedhur në titull shkencor themelojnë marrëdhënie pune dhe realizojnë të drejta dhe detyrime të marrëdhënies së punës në pajtim me këtë apo ligj tjetër.

Me zgjedhjen e kryer në titull shkencor, personi i zgjedhur themelon marrëdhënie pune për kohën për të cilën është zgjedhur.

Në institucionin privat shkencor, në pajtim me personin e zgjedhur nga paragrafi 1 i këtij neni, themelimi i marrëdhënies së punës mund të jetë edhe në kohë më të shkurtër nga koha në të cilën është zgjedhur.

## **Afatet për të cilat kryhen zgjedhjet**

### **Neni 41**



Bashkëpunëtori shkencor, bashkëpunëtori i lartë shkencor dhe këshilltari shkencor zgjidhen në kohë prej pesë vjetësh.

## **Zgjedhja në titull pas skadimit të kohës për të cilën është kryer zgjedhja**

### **Neni 42**

Më së voni gjashtë muaj para skadimit të kohës për të cilën është kryer zgjedhja në titullin shkencor, rektori, përkatësisht drejtori shpall konkurs për zgjedhje në të gjithë titujt shkencorë përkatësisht bashkëpunëtor.

Gjatë zgjedhjes nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohen dispozitat nga ky ligj për zgjedhje dhe tituj bashkëpunëtor.

Koha për shpalljen e konkursit nga paragrafi 1 i këtij neni vazhdon për kohën e cila ka kaluar në pushim lindjeje, pushim mjekësor më gjatë se gjashtë muaj, si dhe pushim i marrëdhënies së punës në raste të përcaktuara me ligj.

## **Zgjedhja para kohe në titull më të lartë**

### **Neni 43**

Zgjedhja në titull më të lartë shkencor mund të bëhet para skadimit të periudhës për të cilin është bërë zgjedhja, nëse personi me titull shkencor i ka të plotësuar kushtet për zgjedhje në titull më të lartë dhe për punën e tij shkencore veçanërisht ka kontribuar për zhvillimin, përkatësisht zbatimin e veprimtarisë shkencore për të cilën është zgjedhur pas skadimit së paku të gjysmës së kohës nga e cila është bërë zgjedhja në titullin ekzistues.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjidhet në titull më të lartë shkencor, nëse ka botuar së paku dy punime shkencore ose janë cituar në revistat më prestigjioze ndërkombëtare me faktor ndikimi.

Ministri me akt nënligjor për së afërmi do t'i përcaktojë mënyrën dhe procedurën për zgjedhje në titull më të lartë shkencor.

Iniciativa për zgjedhje në titull më të lartë para skadimit të afatit, mund të ngrejë këshilli ose drejtori.

Procedura për zgjedhje të parakohshme në titullin më të lartë zbatohet në pajtim me nenet 38 deri në 41 të këtij ligji.

**Personat të cilët nuk janë zgjedhur**

## **Neni 44**

Nëse gjatë zgjedhjes personi i cili paraprakisht është zgjedhur në titullin shkencor propozohet për zgjidhje në titull më të lartë dhe të mos zgjidhet në titullin më të lartë të propozuar, përsëri votohet për zgjedhje në titullin ekzistues në të cilin më herët është zgjedhur.

Personit i cili nuk është i zgjedhur në titull, i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Personi nga paragrafi 2 i këtij neni ka të drejtë në kundërshtim të organi i cili vendos për zgjedhjen. Nëse kundërshtimi do të refuzohet personi ka të drejtë në ankesë te Senati i Universitetit i cili formon komision prej tre anëtarësh, të përbërë prej profesorëve të rregullt përkatësisht këshilltarë shkencorë nga sfera e njëjtë ose e afërt shkencore nga e cila është parashtruesi i ankesës, nga të cilët dy anëtarë janë nga institucioni arsimor sipëror. Komisioni dërgon raport në të cilën jep vlerësim për zgjedhjen. Vendimi i Senatit të Universitetit është përfundimtar.

Për subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore të cilët nuk janë anëtarë të universitetit vendimi i organit i cili vendos për zgjedhje është përfundimtar.

Kundër vendimit përfundimtar mund të parashtrohet ankesë te gjykata kompetente.

## **Ndërprerja e parakohshme e zgjedhjes**

## **Neni 45**

Personi i zgjedhur në titull shkencor është i detyruar që përherë në mënyrë shkencore dhe profesionale të përsoset dhe të dëshmohet, me sukses të realizojë veprimtarinë shkencore, të kontribuojë për krijimin e rinisë shkencore dhe të kontribuojë për zhvillim, përkatësisht zbatimin e veprimtarisë shkencore për të cilën është zgjedhur.

Personit të zgjedhur në titull shkencor mundet t'i pushojë marrëdhënia e punës edhe para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, nën kushte dhe procedurë të rregulluar me Statut, nëse vërtetohet se në kohë më të gjatë nuk i plotëson detyrimet nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse i pengon aktivitetet ligjore dhe statusore të subjektit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore ose i pengon anëtarët e tjerë në realizimin e të drejtave të tyre dhe kryerjen e detyrimeve në subjektet, nëse kanë pushuar të ekzistojnë kushtet themelore në bazë të së cilave është kryer zgjedhja dhe nëse ka bërë vepër penale në lidhje me kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Vendimin për pushim të zgjedhjes dhe marrëdhënies së punës para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur personi në titullin shkencor e merr organi i cili e ka zgjedhur, në

bazë të raportit të përpiluar prej tre këshilltarëve shkencorë, përkatësisht profesorëve të rregullt.

Personi nga paragrafi 1 i këtij neni ka të drejtë në kundërshtim të organi i cili vendos për pushimin e zgjedhjes. Vendimi i organit që vendos është përfundimtar.

Kundër vendimit përfundimtar mund të parashtrohet ankesë te gjykata kompetente.

## **Bashkëpunëtorë - hulumtues**

### **Neni 45-a**

Në fakultete, përkatësisht institucione shkencore nga radhët e studentëve të studimeve të ciklit të dytë ose të tretë përmes konkursit publik mund të zgjidhen bashkëpunëtorë-hulumtues, për nevojat e veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe procesit mësimor-arsimor.

Kushtet dhe mënyrën e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve - hulumtues dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre rregullohen me statutin e universitetit, përkatësisht institucionit shkencor dhe rregullores së njësisë.

Bashkëpunëtorët-hulumtues marrin pjesë në veprimtarin hulumtuese-shkencore dhe procesit mësimor-arsimor në vëllim të përcaktuar me programin studimor.

Institucioni i lartë arsimor dhe bashkëpunëtori-hulumtues lidhin marrëveshje me të cilën i rregullojnë të drejtat dhe detyrimet reciproke.

### **Neni 45-b**

Në institucionet publike shkencore vendet e punës të të punësuarve ndahen në:

- vende të punës së nëpunësve administrativë,
- vende të punës të dhënësve të shërbimeve në institucionet publike shkencore dhe
- vende të punës së personave ndihmës-teknikë.

### **Neni 45-v**

Të punësuarit në Agjenci që kryejnë punë të natyrës administrative kanë status të nëpunësve administrativë.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen kategoritë në vijim dhe niveli i vendit të punës:

- Kategoria B- nëpunës administrativë udhëheqës,
- niveli B2 nëpunës administrativ udhëheqës nga niveli i dytë (sekretar udhëheqës i

shërbimit profesional dhe administrativ),

- Niveli B4 nëpunës administrativ udhëheqës nga niveli i katërt (kontabilist përgjegjës dhe të tjerë),
- Kategoria V- nëpunës administrativë udhëheqës
- niveli V1 këshilltarë ( bibliotekist dhe të tjerë)
- niveli V2 bashkëpunëtor i lartë (lektor, bibliograf dhe të tjerë)
- niveli V3 bashkëpunëtor (dokumentarist - arkivist dhe të tjerë),
- niveli V4 bashkëpunëtor i ri (informatikan dhe të tjerë).
- Kategoria G- nëpunës administrativë udhëheqës,
- niveli G1 referent i pavarur (referent i pavarur për punë afariste dhe të tjera),
- niveli G2 referent i lartë (arkivist dhe të tjerë)
- niveli G3 referent (arkëtar, laborant, referent për mbajtje të evidencës së studimeve nga cikli i tretë dhe katërt dhe të tjerë) dhe
- niveli G3 referent i ri (telefonist-operator, redaktor teknik dhe të tjerë).

### **Neni 45-g**

Të punësuarit në institucionet publike shkencore të cilët kryejnë veprimtari shkencore hulumtuese, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në institucionet shkencore publike dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

Për të punësuarit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen kategoritë në vijim dhe niveli i vendit të punës:

- Kategoria A - hulumtues me tituj shkencorë,
- niveli A1 - këshilltar shkencor,
- niveli A2 - bashkëpunëtor i lartë shkencor dhe
- niveli A3 - këshilltar shkencor,
- Kategoria V - hulumtues me titull bashkëpunës
- niveli V1 - asistent hulumtues dhe
- niveli V2 - asistent i ri hulumtues.

### **Neni 45-d**

Të punësuarit në institucionet publike shkencore të cilët kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të personave ndihmës-teknikë dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni caktohen nëngrupet, kategoritë dhe nivelet e vendeve të punës në vijim:

- nëngrupi 1 kategoria A niveli A1 pastrues dhe të tjerë,

- nëngrupi 2 kategoria A niveli A1 rojtar dhe të tjerë,
- nëngrupi 3 kategoria A niveli A1 shofer dhe të tjerë dhe
- nëngrupi 5 kategoria A niveli A1 korrier (dërgues), portier, ekonom, magazinues dhe të tjerë.

### **Neni 45-gj**

Drejtori i institucionit publik shkencor, pas mendimit paraprak të Ministrisë së Administratës Publike, si dhe pas pëlqimit të Ministrisë për Arsim dhe Shkencë miraton plan vjetor për punësim në institucionet shkencore publike për vitin e ardhshëm, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

### **Neni 45-e**

(1) Personit të zgjedhur në titull shkencor i ndërpritet marrëdhënia e punës në pajtim me dispozitat e marrëdhënieve të punës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, për shkak të kryerjes së pandërprerë të veprimtarisë së institucionit shkencor, me kërkesë paraprake të punëtorit, por në pajtim me këshillin e institucionit, një herë në vit mund të vazhdohet marrëveshja për punësim e personit të zgjedhur me titull shkencor, deri në përfundimin e vitit shkollor në të cilin i plotëson kushtet për arritjen e pensionit të pleqërisë ose më së shumti deri në përfundimin e vitit shkollor në të cilin mbush 67 vjet të moshës.

(3) Kërkesa për vazhdimin e marrëdhënies së punës sipas paragrafit (2) të këtij neni, dorëzohet një herë në vit, më së voni deri më 31 gusht në vitin aktual për vazhdimin e marrëveshjes për punësim për vitin e ardhshëm.

### **Rroga e të punësuarve në institucionet publike shkencore**

#### **Neni 45-zh**

(1) Të punësuarit në institucionet publike shkencore kanë të drejtë të rrogës në përpjesëtim me punën e kryer dhe kontributin në institucionin shkencor publik, kompensime të rrogës, shtesa të rrogës dhe të ardhura të tjera, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, me marrëveshjen kolektive dhe me marrëveshjen e punësimit.

(2) Rroga e të punësuarve në institucionet shkencore publike, paguhet nga mjetet e llogarisë buxhetore në varësi të llojit, vëllimit, kompleksitetit dhe përgjegjësisë në kryerjen e punës në vendin e punës.

(3) Të drejtat e rrogës, kompensimet e rrogës, shtesat e rrogës dhe të ardhurat e tjera, të cilat nuk janë rregulluar me këtë apo me ndonjë ligj tjetër, rregullohen me marrëveshjen kolektive dhe me marrëveshjen e punësimit.

(4) Rroga bazë e të punësuarit përbëhet nga

- rroga minimale,
- pjesa e rrogës për emërtim/titull, dhe
- pjesa e rrogës për stazh.

(5) Rroga bazë e të punësuarit me orar të plotë të punës caktohet në mënyrën që shuma e rrogës minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e përcaktuar në përputhje me ligjin, të shumëzohet me koeficientin sipas emërimit/titullit të vendit të punës të përcaktuar në nenin 45-z të këtij ligji.

(6) Pjesa e rrogës për stazhin e punës për të punësuarin vlerësohet në shumën prej 0,5% të rrogës bazë nga paragrafi (5) i këtij neni, për çdo vit të përfunduar, ndërsa më së shumti deri në 20%.

### Koeficienti për pagesën e rrogës për të punësuarit në institucionet publike shkencore

#### Neni 45-z

Koeficienti për pagesën e rrogës përcaktohet në mënyrën si vijon:

<b>grupi III - Vendet e punës së ofruesve të shërbimeve publike në institucionin publik</b>			
<b>nëngrupi 2 - ofruesit e shërbimeve publike në fushën e arsimit dhe të shkencës</b>			
Niveli	Titulli	Koeficienti 2024	Koeficienti 2025
A1	Këshilltar shkencor / profesor i rregullt, dr.	3,74	4,4
A2	Bashkëpunëtor i lartë shkencor / profesor inordinar, dr.	3,4	4,0
A3	Bashkëpunëtor shkencor / docent, dr.	3,06	3,6
V1	Bashkëpunëtor hulumtues në ciklin e tretë të studimeve (Asistent doktorant / asistent hulumtues)	2,295	2,7
V1	Asistent hulumtues / asistent, mr.	2,295	2,7
V2	Bashkëpunëtor hulumtues i regjistruar në ciklin e dytë të studimeve / Asistent i ri hulumtues / asistent i ri arsimit i lartë	1,955	2,3

**grupi I - Vendet e punës së nëpunësve administrativë në institucionin e sektorit publik**

Niveli	Vendi i punës	Koeficienti 2024	Koeficienti 2025
B2	sekretar, udhëheqës i shërbimit profesional dhe administrativ	2,465	2,9
B4	kontabilist përgjegjës dhe të tjerë	2,295	2,7
V1	këshilltar (bibliotekar dhe të tjerë - këshilltar për studime të magjistraturës dhe doktoraturës; referent për studime; bashkëpunëtor për mësimdhënie dhe shkencë;	1,955	2,3
V2	-bashkëpunëtor i lartë (lektor, bibliograf dhe të tjerë - korrektues, redaktor teknik, bashkëpunëtor për veprimtarinë botuese dhe të tjerë)	1,785	2,1
V3	- bashkëpunëtor (dokumentarist-arkivist, melograf, deshifruer dhe të tjerë)	1,7	2,0
V4	bashkëpunëtor i ri (informaticient dhe të tjerë)	1,615	1,9
G1	-referent i pavarur për punën afariste (arkivist; arkëtar; sekretar afarist-arkivist; sekretar teknik; bibliotekist i pavarur; referent i pavarur; teknik kompjuteristik; për punën e magazinës; dhe të tjerë)	1,445	1,7
G2	referent i lartë (arkivist; teknik informatik dhe të tjerë)	1,36	1,6
G3	referent (arkëtar; laborant; referent për mbajtjen e evidencës së studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë dhe të tjerë)	1,275	1,5
G4	referent i ri (telefonist-operator, redaktor teknik dhe të tjerë)	1,19	1,4

**grupi IV - Vendet e punës të personave ndihmës-teknikë në institucionin e sektorit publik**

Niveli	Vendi i punës	Koeficienti 2024	Koeficienti 2025
A1	- higjienist; - higjienist (korrier); - nikoqir; - punonjës i përgjithshëm dhe të tjerë; - punonjës i mirëmbajtjes së shtëpisë	1,1	1,2
A1	rojtar	1,1	1,3
A1	shofer dhe të tjerë	1,2	1,3
A1	- korrier (dërgues), portier, ekonom, magaznier; dhe të tjerë.	1,2	1,3

## X. SIGURIMI I KUALITETIT NË VEPRIMTARINË HULUMTUESE-SHKENCORE

### Neni 46

Ministria e përcjell realizimin e Programit nacional dhe siguron kushte për përmirësimin e kualitetit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Për realizimin e aktiviteteve nga paragrafi 1 i këtij neni Ministria i kryen punët si vijon:

- e përcjell kualitetin e zbatimit të programeve vjetore për veprimtarinë hulumtuese-shkencore të universiteteve shtetërore, institucioneve publike shkencore dhe qendrave shkencore ekskluzive,
- e përcjell kualitetin e institucioneve private shkencore, institucioneve të përziara shkencore dhe hulumtuesve të pavarur nëse bashkëfinancon programe të tyre dhe projekte ose u siguron lloj tjetër përkrahjeje,
- zbaton kontroll të shfrytëzimit të dedikuar të mjeteve të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në baza të tjera,
- siguron shfrytëzim falas të literaturës shkencore në salla leximi të veçanta të cilat i formon për atë dedikim,
- zbaton program për krijimin dhe aftësimin e kuadrove të reja hulumtuese-shkencore,
- planifikon, orienton dhe financon aktivitet për promocion të veprimtarisë hulumtuese-shkencore dhe bartje të njohurive,
- furnizim dhe modernizim të pajisjeve hulumtuese,
- siguron këshillim dhe përkrahje profesionale të bartësve të projekteve hulumtuese-shkencore,
- nxit dhe përkrah bashkëpunim ndërkombëtar dhe bartje të njohurive ndërkombëtare,
- nxit lidhje dhe bartje të njohurive ndërmjet subjekteve për kryerjen e veprimtarive hulumtuese-shkencore dhe ekonomike,
- kujdeset për sigurimin e mjeteve plotësuese për zbatimin e Programit nacional, në bashkëpunim me ministri të tjerë dhe donatorë,



- siguron transparencë në punë,
- siguron qasje te informatat shkencore, dhe
- e informon publikun për realizimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

#### **Neni 47**

Subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore janë të detyruar të kryejnë vetë evaluacionit për kualitetin e veprimtarisë së tyre hulumtuese-shkencore përmes sistemit të vet për udhëheqje me kualitetin e veprimtarisë.

Lëndë e evaluacionit është aktiviteti gjithëpërfshirës i subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Evaluacioni i brendshëm (vetevaluacion) subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore e kryejnë në pajtim me statutin e vet dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare për evaluacion.

Evaluacioni i jashtëm kryhet ekskluzivisht në bazë të standardeve ndërkombëtare nga ana e Agjencisë për evaluacion në pajtim me Ligjin për arsim sipëror.

Subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore janë të detyruar t'i sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informacionet për evaluacion dhe të bashkëpunojnë veçanërisht kur realizohet evaluacioni i jashtëm.

Rezultatet nga evaluacioni i jashtëm prezantohen në mënyrë publike së paku një herë në vit me kërkesën e Ministrisë.

#### **Neni 48**

Nëse Ministria vërteton se subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore nuk i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj, do të caktojë afat për plotësimin e tyre, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.

Nëse subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore në afatin e paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj, Ministria miraton aktvendim për shlyerje nga Regjistri të subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, me çka e njofton themeluesin.

Kundër aktvendimit përfundimtar të ministrit nga paragrafi 2 i këtij neni mundet t'i parashtrohet padi Gjykatës Administrative.

## **XI. FINANCIMI I VEPRIMTARISË HULUMTUESE-SHKENCORE**

## Neni 49

Mjetet për financimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me qëllimet dhe prioritetet e përcaktuara në Programin nacional si dhe në programet zhvillimore me interes publik për Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nga burime të tjera: programet dhe fondet ndërkombëtare, njësitë e vetadministrimit lokal, personat juridikë, të ardhurat personale, legatët, dhuratat, testamentet, dokumentet shtesë dhe burime të tjera.

Me mjetet e përfituara nga legatë, dhurata, testamente dhe dokumente shtesë, subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore disponojnë në bazë të dedikimit të dhënësit.

## Neni 50

Ministria me konkurs publik i financon programet vjetore për veprimtari hulumtuese-shkencore të subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore, edhe atë:

- programe hulumtuese-shkencore dhe projekte,
- infrastrukturë hulumtuese-shkencore,
- aftësim, zhvillim dhe krijim të kuadrove hulumtuese-shkencore,
- bashkëpunim kërkimor-shkencor dhe bartje të njohurive dhe shkathtësive,
- promovimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore,
- botimin e librave shkencorë, përmbledhjeve vjetore dhe revistave shkencore, botimin e punimeve vendëse shkencore në revista të huaja shkencore, dhe botimin e punimeve të huaja shkencore në gjuhën maqedonase dhe gjuhët e bashkësive,
- organizimin e mbledhjeve shkencore,
- pjesëmarrje të hulumtuesve vendës shkencorë në mbledhje ndërkombëtare shkencore dhe vendqëndrime studimore jashtë vendit,
- vendqëndrime të hulumtuesve të huaj shkencorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe
- dedikime të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në bazë të mendimit të Këshillit Nacional, Ministria me konkurs publik mund të financojë edhe projekte shkencore hulumtuese me interes të veçantë shkencor dhe publik.

Ministria me konkurs publik mund të financojë edhe veprimtari krijuese të institucioneve shkencore dhe të arsimit të lartë me të cilat stimulohet kujdesi i vazhdueshëm për përsosje dhe prezantim më të gjerë të veprimtarive krijuese që kanë ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e kompetencave të kuadrit arsimor, e me këtë të kompetencave edhe të studentëve.

Kriteret e veçanta për financim të veprimtarive krijuese nga paragrafi 3 i këtij neni, i përcakton ministri.

Mënyrën e financimit të organizimit të takimeve shkencore dhe pjesëmarrjes së hulumtuesve shkencorë vendorë në takime shkencore dhe qëndrime studimore ndërkombëtare jashtë vendit i përcakton ministri.

Për financimin e programeve vjetore të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, Ministria lidh marrëveshje me subjektet për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore në të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke. Nëse nga projekti hulumtues del patentë ose inovacion në të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut ka bashkëfinancuar, në pajtim me ligjin, është pronar i të njëjtëve në përpjesëtim me pjesën e bashkëfinancimit.

## **Neni 51**

Financimi i programeve vjetore për veprimtarinë hulumtuese-shkencore kryhet në bazë të kriterëve si vijon:

- nxitjes dhe ndihmës së subjekteve të veprimtarisë hulumtuese-shkencore në realizimin e veprimtarisë hulumtuese-shkencore,
- realizimit të interesit publik të përcaktuar me këtë ligj,
- zhvillimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- thellimit dhe zgjerimit të vëllimit dhe kualitetit të njohurive shkencore,
- zbatimit efikas të rezultateve hulumtuese-shkencore në zgjidhjen e problemeve ekonomike, sociale, kulturore, arsimore, shëndetësore, ekologjike dhe problemeve të tjera, dhe
- përfshirjes ndërkombëtare dhe afirmim të shkencës.

Bashkëfinancimi i veprimtarisë botuese kryhet në bazë të kriterëve si vijon:

- kontributit në thellimin dhe zgjerimin e njohurive shkencore,
- origjinalitetit të qëllimeve dhe përmbajtjet e hulumtimit, dhe
- konkurrencës në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Në konkurset publike për shpërndarjen e mjeteve për financim të programeve hulumtuese-shkencore dhe projekteve, gjatë shpërndarjes së mjeteve, së pari do t'u shpërndahen atyre që kanë botuar punime në revista me faktor ndikues në tre vitet e fundit, së paku dy punë në tre vitet e fundit, ndërsa mjetet tjera do të shpërndahen atyre të cilët nuk kanë shpallur të atilla punë ose projekte.

## **Neni 52**

Institucioneve private shkencore, institucioneve të përziera shkencore, institucioneve private arsimore sipërore dhe të hulumtuesve të pavarur nga Buxheti i Republikës së

Maqedonisë së Veriut u sigurohen mjete për financimin e projekteve dhe programeve hulumtuese-shkencore.

Për prezantimin e rezultateve të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, hulumtuesit përmes ndërmarrjeve veprimtaria bazë e së cilës është botimi, mund të botojnë libra shkencorë, me çka sigurohen mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për financimin, krijimin dhe përsosjen e kuadrove hulumtuese-shkencore nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut sigurohen mjete për bursa: studime pasuniversitare, studime doktorature, studime pas doktoratës si dhe për kompensime të njëfishtë për përpunimin e punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës.

Mjetet për financim, krijim dhe përsosje të kuadrove hulumtuese-shkencore u ndahen për:

- krijimin e kuadrove të reja hulumtuese-shkencore të cilat do të kontribuojnë në thellimin dhe kualitetin e njohurive shkencore dhe zbatimin efikas të rezultateve hulumtuese-shkencore,
- përfitimin e shkallës magjistër dhe doktor shkence, dhe
- sigurimin e kuadrove të reja hulumtuese-shkencore në pajtim me nevojat e hulumtimeve shkencore.

Mjetet nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni sigurohen përmes konkursit publik që e shpall Ministria.

Për paraqitjen në konkursin nga paragrafi 5 i këtij neni për bursa për studime akademike të ciklit të dytë jashtë vendit për studentë të pranuar në studimet akademike të ciklit të dytë në njërin ndër njëqind universitetet e para të ranguara në listën e fundit të publikuar në Qendrën e Universiteteve nga klasa botërore në Universitetin Xhio Tong të Shangait parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- diploma për studime akademike të mbaruara të ciklit të parë dhe certifikatë për suksesin e arritur (të verifikuar në noter) apo diploma e nostifikuar për studime akademike të ciklit të parë të marra jashtë vendit;
- vërtetimi nga institucioni i arsimit të lartë se kandidati është pranuar për herë të parë në vitin e parë të studimeve akademike të ciklit të dytë në vitin akademik rrjedhës, prej kur fillon semestri dhe sa semestra zgjasin studimet;
- dëshmi/vërtetimi për njohjen aktive të gjuhës (TOEFEL, IELTS, DELFT apo ekuivalentin e tyre për zonën gjuhësore përkatëse), përveç për kandidatët të cilët një pjesë të arsimit të tyre të mesëm, respektivisht të arsimit të tyre të lartë e kanë mbaruar në gjuhën në të cilën realizohet mësimi;
- deklaratë e nënshkruar me dorën e vet se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës për studimet akademike të ciklit të dytë nga dhënësit tjerë (të verifikuar në noter);
- dy rekomandime nga profesorët universitarë të institucionit/eve në të cilat kandidati ka marrë studime deridiplomike të ciklit të parë dhe rekomandim nga punëdhënësi i tij (nëse

është në marrëdhënie pune);

- letra motivuese dhe

- dëshmi e shtetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për paraqitjen në konkurs nga paragrafi 5 i këtij neni për bursa për studimet akademike të ciklit të tretë jashtë vendit për studentë të pranuar në studimet akademike të ciklit të tretë, në njërin ndër njëqind universitetet e para të ranguara në listën e fundit të publikuar në Qendrën e Universiteteve nga klasa botërore në Universitetin Xhio Tong të Shangait parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- vërtetimi i universitetit (fakultetit / institutit), respektivisht shkolla e doktorit në të cilën është pranuar në ciklin e tretë të studimeve (të doktoraturës);

- dëshmi/diploma për ciklin e parë dhe të dytë të mbaruar të studimeve;

- kopja e tri punimeve hulumtuese shkencore të botuara në tri vitet e fundit, në revistat shkencore ndërkombëtare apo publikimet shkencore ndërkombëtare nga sfera shkencore me të cilën kanë të bëjnë studimet e doktoraturës;

- dëshmi/vërtetimi për njohjen aktive të gjuhës së huaj (TOEFEL, IELTS, DELFT apo ekuivalentin e tyre për zonën gjuhësore përkatëse), përveç për kandidatët të cilët arsimin e tyre akademik paraprak e kanë mbaruar në gjuhën në të cilën realizohet mësimi;

- prova/vërtetimi i lëshuar nga punëdhënësi për përvojën e punës;

- dy rekomandime nga profesorët universitarë, apo punëdhënësi (nëse është në marrëdhënie pune);

- deklarata e verifikuar në noter se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës nga dhënësit tjerë;

- dëshmi e shtetësisë dhe

- certifikata nga libri i amzës së të lindurve.

Për paraqitjen në konkurs nga paragrafi 5 i këtij neni për bursa për studime të ciklit të dytë nga sfera e artit muzikor dhe të filmit të Akademisë së Artit Filmik dhe Artit Televiziv (FAMU) në Pragë, Republika e Çekisë, parashtrohet kërkesë dhe dërgohet:

- diplomë për studimet akademike të mbaruara të ciklit të parë dhe dëshmia për suksesin e arritur (të verifikuar në noter) apo diploma e nostifikuar për studimet akademike të ciklit të parë të marrë jashtë vendit;

- vërtetim se kandidati është pranuar për herë të parë në vitin e parë të studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik rrjedhës të Akademisë së Artit Filmik dhe Artit Televiziv (FAMU) në Pragë, Republika e Çekisë;

- deklaratë e nënshkruar me dorën e vet se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës për studimet e ciklit të dytë nga dhënësit tjerë (e verifikuar në noter);

- letër motivuese;

- vërtetimi për njohjen e gjuhës angleze, respektivisht gjuhës në të cilën realizohet mësimi (TOEFEL, IELTS apo ekuivalenti i tyre për zonën gjuhësore përkatëse) dhe

- dëshmi e shtetësisë.

Për paraqitjen në konkurs nga paragrafi 5 i këtij neni për bursa për studimet pasdiplomike të ISHP Instituti i Filmit, Akademia e Filmit - Ohër, parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- diplomë për studime akademike të mbaruara të ciklit të parë dhe dëshmi për suksesin e arritur (të verifikuara në noter);
- vërtetim se kandidati është pranuar për herë të parë në vitin e parë të studimeve të ciklit të parë në vitin akademik rrjedhës në ISHP Instituti i Filmit, Akademia e Filmit - Ohër;
- deklaratë e nënshkruar me dorën e vet se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës për studime pasdiplomike të ciklit të dytë nga dhënësit tjerë (të verifikuar në noter); dhe
- vërtetim për njohjen e gjuhës angleze.

Për paraqitjen në konkursin nga paragrafi 5 i këtij neni për bursa për studime akademike të ciklit të dytë për studentët e pranuar në studime akademike të universiteteve me renome nga sferat e artit figurativ, kinematografisë dhe produksionit filmik, artit dramatik dhe muzikës, parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- diplomë për studime akademike të mbaruara të ciklit të parë dhe/apo dëshmi (të verifikuara në noter) apo diplomë e nostifikuar për studimet akademike të ciklit të parë të marrë jashtë vendit;
- vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë se kandidati është pranuar për herë të parë në vitin e parë të studimeve akademike të ciklit të dytë në vitin akademik rrjedhës, prej kur fillon semestri dhe sa semestra zgjasin studimet;
- dëshmi/vërtetim për njohjen aktive të gjuhës (TOEFEL, IELTS, DELFT apo ekuivalentin e tyre për zonën gjuhësore përkatëse), përveç për kandidatët të cilët një pjesë të arsimit të tyre të mesëm, respektivisht të arsimit të tyre të lartë e kanë mbaruar në gjuhën në të cilën realizohet mësimi;
- deklaratë e nënshkruar me dorën e vet se kandidati nuk është shfrytëzues i bursës për studime akademike të ciklit të dytë nga dhënësit tjerë (të verifikuar në noter);
- letër motivuese dhe
- dëshmi e shtetësisë.

Për paraqitjen në konkursin nga paragrafi 5 i këtij neni për ndarjen e mjeteve të njehershme për hartimin e punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- vërtetim se punimi i magjistraturës, respektivisht punimi i doktoraturës është pranuar për hartim nga këshilli shkencor mësimor, respektivisht këshilli shkencor i institucionit;
- deklaratë e verifikuar në noter se në ditën e parashtrimit të kërkesës punimi nuk është mbrojtur;
- dëshmi apo diplomë për studimet e mbaruara të ciklit të parë, respektivisht të ciklit të dytë të studimeve (të verifikuara në noter);
- vërtetime për njohjen e gjuhëve të huaja;
- dëshmi e shtetësisë;
- certifikatë nga libri amë i të lindurve.

Formularët e kërkesave nga paragrafët 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij neni i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit.

Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për konkurset nga paragrafët 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij neni ka për detyrë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, me detyrë zyrtare të kërkojë dokumentacionin nga paragrafi 6 alineja 7, paragrafi 7 alinetë 8 dhe 9, paragrafi 8 alineja 6 dhe paragrafi 10 alineja 6 dhe paragrafi 11 alinetë 5 dhe 6 të këtij neni për të cilën organi publik kompetent mban evidencë zyrtare.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent prej të cilit është kërkuar dokumentacioni nga paragrafi 6 alineja 7, paragrafi 7 alinetë 8 dhe 9, paragrafi 8 alineja 6 dhe paragrafi 10 alineja 6 dhe paragrafi 11 alinetë 5 dhe 6 të këtij neni ka për detyrë ta dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Ministria ka për detyrë të vendosë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafët 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij neni.

#### **Neni 52-a**

Për paraqitjen në konkursin për ndarjen e mjeteve të njehershme financiare të dedikuara për veprimtaritë krijuese parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- provë për pjesëmarrjen në festival që është anëtar i Asociacionit Evropian të Festivaleve (European Festivals Association);
- provë për pjesëmarrjen në projektin ndërkombëtar dhe manifestimin jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, si përfaqësues nacional, apo
- provë për pjesëmarrjen në projektin ndërkombëtar dhe manifestimin jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku zgjedhja e pjesëmarrësve publikohet në formë të konkursit, audicionit apo selektimit dhe
- certifikatë e shtetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për paraqitjen në konkurs për ndarjen e mjeteve për financimin e organizimit të mbledhjeve shkencore parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- vendim i organizatorit për mbajtjen e mbledhjes shkencore;
- vendim për botimin e përmbledhjes së punimeve nga mbledhja shkencore dhe
- programi për punën e mbledhjes shkencore.

Për paraqitjen në konkurs për pjesëmarrjen e hulumtuesve shkencorë vendorë në mbledhjet shkencore ndërkombëtare parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- provë se punimi është pranuar për prezantim me gojë apo me shkrim nga organizatori i mbledhjes shkencore ndërkombëtare;
- pëlqim nga institucioni ku është i punësuar kandidati për pjesëmarrje në mbledhjen

shkencore ndërkombëtare;

- vërtetim për lartësinë e shpenzimeve të rrugës;
- vërtetim për lartësinë e kotizimit dhe
- abstrakt i punimit shkencor.

Për paraqitjen në konkurs për ndarjen e mjeteve të njehershme financiare për punimin e botuar hulumtues shkencor parashtrohet kërkesë dhe dorëzohet:

- kopje e punimit të botuar hulumtues shkencor nga autori vendor në revistën shkencore ndërkombëtare me faktorin e ndikimit (impakt faktori);
- kopje e faqes së revistës shkencore ndërkombëtare ku është theksuar titulli, viti dhe numri i revistës, këshilli i redaktimit dhe botuesi i revistës në të cilën është botuar punimi hulumtues shkencor;
- dokument zyrtar, vërtetim për lartësinë e faktorit të ndikimit (impakt faktorin) për revistën shkencore ndërkombëtare;
- dëshmi e shtetësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- kopje e faturës, respektivisht fletëpagesës për botimin e punimit, të parashtruar nga institucioni, respektivisht hulumtuesi i pavarur, apo deklaratë e parashtruar nga institucioni, respektivisht hulumtuesi i pavarur.

Formularët e kërkesave nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni i përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e arsimit.

Personi i autorizuar zyrtar i Ministrisë i cili e mban procedurën për konkurset nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni ka për detyrë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, me detyrë zyrtare të kërkojë dokumentacionin nga paragrafi 1 alineja 4 dhe paragrafi 4 alineja 4 të këtij neni për të cilin organi publik kompetent mban evidencë zyrtare.

Personi i autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent prej të cilit është kërkuar dokumentacioni nga paragrafi 1 alineja 4 dhe paragrafi 4 alineja 4 të këtij neni ka për detyrë ta dërgojë dokumentacionin e kërkuar në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Ministria ka për detyrë të vendosë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni.

## **XII. EVIDENTIMI I SUBJEKTEVE DHE REZULTATET E VEPRIMTARISË HULUMTUESE-SHKENCORE**

**Regjistri i subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore**

**Neni 53**



Ministria mban Regjistër të subjekteve për kryerjen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

Ministri e përcakton formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të subjekteve të cilat kryejnë veprimtari hulumtuese-shkencore.

Aktvendim për regjistrim në Regjistrin e subjekteve të cilat kryejnë veprimtari hulumtuese-shkencore miraton Ministria nëse janë plotësuar kushtet e parapara me këtë ligj.

## **Baza e të dhënave për veprimtari hulumtuese -shkencore**

### **Neni 54**

Për përcjelljen e veprimtarisë hulumtuese-shkencore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ministria siguron kushte për formim dhe sigurim të:

- bazave të të dhënave për institucionet hulumtuese-shkencore,
- bazave të të dhënave për hulumtuesit shkencorë,
- bazë për punime të doktoraturës,
- bazë për kontrollin e plagjiaturave të punimeve të magjistraturës, punimeve profesionale specialistike dhe punimeve seminarike,
- bazës së të dhënave për hulumtues në vend dhe jashtë vendit (nauka.mk)
- bazave të të dhënave për programe hulumtuese shkencore dhe projekte (vendase dhe ndërkombëtare), dhe
- bazave të të dhënave për bibliografit e hulumtimeve shkencore.

Bazat e të dhënave formohen dhe mirëmbahen në korniza të sistemit nacional informativ për veprimtarinë hulumtuese-shkencore dhe sistemin nacional bibliotekar - informativ, përveç bazave nga alinetë 3, 4 dhe 5 të cilat formohen dhe mbahen në Ministri.

Punimin e doktoraturës detyrimisht e fut në bazën e punimeve të doktoraturës mentori i punimit të doktoraturës, së paku 30 ditë para mbrojtjes së punimit të doktoraturës.

Punimin e magjistraturës, përkatësisht punimin profesional specialistik detyrimisht e fut në bazë për kontrollin e plagjiaturave mentori i punimit të magjistraturës, përkatësisht punimit profesional specialistik, së paku 30 ditë para mbrojtjes së punimit të magjistraturës, përkatësisht punimit profesional specialistik.

Punimin seminarik të studentit detyrimisht e fut në bazë për kontrollin e plagjiaturave mësimdhënësi i lëndës përkatëse mësimore, së paku dhjetë ditë para vlerësimit të punimit seminarik.

Hulumtuesit detyrimisht regjistrohen në bazën e të dhënave për hulumtues në vend dhe jashtë vendit (nauka.mk).

Hulumtuesit detyrohen që t'i fusin të gjitha ndryshimet e të dhënave në bazën e të dhënave për hulumtues në vend dhe jashtë vendit (nauka.mk) në afat prej 60 ditësh nga dita e ndryshimit të krijuar.

Ministri e përcakton mënyrën dhe procedurën për mbajtjen e bazave të të dhënave.

Institucionet hulumtuese-shkencore dhe të arsimit të lartë janë të obliguara të dorëzojnë të dhëna për bazën e të dhënave që e mban Ministria.

## **Regjistrimi në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

### **Neni 55**

Pas konstituimit dhe zgjedhjes së organeve të institucionit publik shkencor, institucionit të përzier shkencor dhe institucionit privat shkencor bëhet regjistrimi i institucionit publik shkencor, institucionit të përzier shkencor, institucionit privat shkencor dhe hulumtuesit të pavarur në Regjistrin Qendror, me çka përfiton cilësi të personit juridik.

### **Ndryshimet statusore**

### **Neni 56**

Institucioni shkencor publik, me pajtimin paraprak të themeluesit, mund të bashkojë, ndajë ose bashkëngjitë, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj dhe Statut të institucionit.

Themeluesi mund të vendosë që një pjesë nga institucioni publik (njësi organizative) të bashkohet me institucion tjetër ose të organizohet si institucion publik shkencor.

Institucioni i përzier, me pajtimin paraprak të bashkëthemeluesve, mund të bashkojë, ndajë ose bashkëngjitë, nën kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj dhe Statut të institucionit.

## **XIII. AUTORIZIMET PËR DISPOZITAT NËNLIGJORE**

### **Neni 57**

Autorizohet ministri të miratojë dispozita nënligjore për:

- procedurën dhe kriteret më të afërta për financim dhe mbikëqyrje të programeve vjetore për veprimtarit hulumtuese-shkencore të subjekteve të veprimtarisë hulumtuese-

shkencore,

- mënyrën dhe procedurën për financim të projekteve hulumtuese-shkencore përkatësisht programeve,
- procedurën dhe kriteret më të afërta për bashkëfinancimin e veprimtarisë botuese,
- mënyrën dhe procedurën për financim, krijim dhe përsosje të kuadrove hulumtuese-shkencore,
- mënyrën dhe procedurën për zgjedhje në titull më të lartë shkencorë,
- procedurën dhe kriteret më të afërta për zgjedhje të parakohshme në titull shkencorë, dhe
- mënyrën dhe procedurën e mbajtjes së bazës së të dhënave.

#### XIV. MBIKËQYRJA

##### Neni 58

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e kryen Ministria.

#### XV. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE

##### Neni 59

Personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 301 deri 400 euro, në kundërvlerë denari, për kundërvajtje, nëse:

- në institucionin shkencor zbatohet statuti për të cilin nuk është marrë pëlqimi nga organi kompetent (neni 21 i këtij ligji),
- në institucionin shkencor bëhet zgjedhja e personave në tituj shkencorë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji (nenet nga 35 deri në 44 të këtij ligji),
- nuk dorëzohen të dhënat për bazën e të dhënave që e mban Ministria (neni 54 paragrafi 9 i këtij ligji) dhe
- në institucionin shkencor bëhen ndryshimet e statusit pa pëlqimin e themeluesit (neni 56 i këtij ligji).

Gjobë në shumë nga 100 deri 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet hulumtuesit për kundërvajtjen nga paragrafi 1 alineja 4 të këtij neni.

Gjobë në shumë nga 15 deri 35 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga Ministria që e mban procedurën, nëse:

- nuk i merr provat në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 52 paragrafi 13 dhe neni 52-a paragrafi 6 të këtij ligji);
- nuk vendos për kërkesën në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 52 paragrafi 15 dhe neni 52-a paragrafi 8 të këtij ligji).

Gjobë në shumë nga 15 deri 35 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent prej të cilit janë kërkuar provat dhe të dhënat nëse nuk i dërgon provat dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 52 paragrafi 14 neni 52-a paragrafi 7 të këtij ligji).

## **Neni 60**

### *I fshirë*

#### **Neni 60-a**

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 59 nga ky ligj, inspektori shtetërorë arsimorë është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes t'i jep urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Nëse kryerësi e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, të njëjtën duhet ta nënshkruaj. Pranimi i urdhërpagesës kundërvajtëse nga kryerësi i kundërvajtjes shënohet në procesverbal.

Në procesverbalin nga paragrafi 2 i këtij neni përcaktohet mënyra në të cilën do të hiqen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja, si dhe mënyra e tejkalimit të pasojave nga kundërvajtja e bërë.

Inspektori shtetërorë arsimorë është i detyruar të mbajë evidencë për urdhërpagesat kundërvajtëse të lëshuara dhe për rezultatin e procedurës së ngritur.

Në evidencën nga paragrafi 4 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht emërtimi i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse e cila i jepet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 5 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencën.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

#### **Neni 60-b**

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

## XVI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### Neni 61

Instituti për Histori Nacionale - Shkup, Instituti për Gjuhë Maqedonase "Kërste Misirkov" - Shkup, Instituti për Folklor "Marko Cepenkov" - Shkup, Instituti për Literaturë Maqedonase - Shkup, Instituti për Kulturë të Vjetër Sllave - Prilep, Instituti për Trashëgimi Kulturore Shpirtërore të Shqiptarëve - Shkup dhe Enti i Hidrobiologjisë – Ohër me hyrjen në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të punojnë si institucione publike shkencore.

Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Politike - Juridike - Shkup, Instituti për Blegtori - Shkup, Instituti Bujqësor - Shkup, Instituti për Inxhinieri Tërmetesh dhe Inxhinieri Sizmologjike - Shkup, Instituti Ekonomik - Shkup, Institut për Duhan - Prilep dhe Instituti për Kultura Bujqësore Jugore - Strumicë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të punojnë si njësi të drejtuara ndaj shkencës (instituteve shkencore) të universiteteve publike.

Institucionet publike shkencore nga paragrafi 2 i këtij neni, në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për arsim sipëror, ndërsa me pëlqim paraprak të themeluesit dhe Statusit, më së voni deri më 31 dhjetor 2008, mund të bashkohen, ndahen ose bashkëngjiten me universitetet publike ose të fillojnë me transformimin në përputhje me Ligjin për institucionet.

### Neni 62

Institucionet tjera shkencore dhe hulumtuesit e pavarur të themeluar në bazë të Ligjit për veprimtari hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", numër 13/1996 dhe 29/2002 janë të detyruara që në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji t'i harmonizojnë aktet e tyre, organizimin dhe punën e tyre me dispozitat e këtij ligji.

Për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, ministri miraton aktvendim, me çka bëhet regjistrimi në Regjistrin e subjekteve të veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

Subjektet e veprimtarisë hulumtuese-shkencore të cilat në afatin e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni nuk do t'i plotësojnë kushtet e nevojshme, nuk regjistrohen në regjistër, përkatësisht e humbin statusin e subjektit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore.

### Neni 63

Zgjedhjet në tituj shkencorë dhe bashkëpunëtor të filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të mbarojnë në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për veprimtari

hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 13/1996 dhe 29/2002)

#### **Neni 64**

Qeveria në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të emërojë kryetar dhe anëtar të Këshillit.

#### **Neni 65**

Ministri në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të emërojë kryetar dhe anëtar të Këshillit.

#### **Neni 66**

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do ta miratojë Programin nacional për veprimtari hulumtuese-shkencore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **Neni 67**

Titujt shkencorë dhe bashkëpunëtorë të përcaktuar në Ligjin për veprimtari hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 13/1996 dhe 29/2002 janë ekuivalentë me titujt mësimorë-shkencorë të rregulluar me Ligjin për arsim sipëror.

Titujt shkencorë të fituar në bazë të ligjit nga paragrafi 1 i këtij neni, u përgjigjen titujve vijues të përcaktuar me ligjin që ka të bëjë me arsimin sipëror: këshilltar shkencor - profesor ordinar; bashkëpunëtor i lartë shkencor - profesor inordinar; bashkëpunëtor shkencor - docent në arsimin sipëror.

#### **Neni 68**

Ministri do t'i miratojë dispozitat nënligjore të parapara me këtë ligj në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në hyrjen në fuqi të dispozitave nënligjore nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen dispozitat ekzistuese nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 69**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për mbajtjen e evidencës në sferën e punës shkencore, kulturore-arsimore dhe teknike jashtë vendit ("Fleta zyrtare e RSFJ-së",

numër 4/1978) dhe shfuqizohet Ligji për veprimtari hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 13/1996 dhe 29/2002).

#### **Neni 70**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### **DISPOZITA NGA LIGJET PËR NDRYSHIM DHE/OSE PLOTËSIM**

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008):

#### **Neni 19**

Bashkëpunëtoreve të punësuar në institucionet shkencore të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji e kane marre shkallen shkencore magjistër, nëse deri më 15 shtator 2013 nuk zgjidhen në titujt shkencore, u pushon marrëdhënia e punës.

Bashkëpunëtoreve të punësuar në institucionet shkencore të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk e kane marre shkallen shkencore magjistër, nëse deri më 15 shtator 2020 nuk zgjidhen në titujt shkencore, u pushon marrëdhënia e punës.8

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 24/2011 dhe 154/2015):

#### **Neni 18**

Dispozita nga neni 14 i këtij ligji, do të zbatohet nga 15 shtatori 2011.

#### **Neni 20**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tete nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet prej 15 shtatorit të vitit 2020.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/2013):

#### **Neni 7**

Ministria pa shpalljen e konkursit publik do të paguaje mjete për kompensime të njehershme për përpunimin e punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës me kërkesa të parashtruara në periudhën 15 prill 2008 deri më 8 shkurt 2012 për kandidatet që i plotësojnë kushtet si vijojnë: punimi i magjistraturës, respektivisht i doktoraturës t'i pranohet për përpunim nga Këshilli Arsimor Shkencor, respektivisht Këshilli Shkencor i institucionit ku është paraqitur, në ditën e parashtrimit të kërkesës kandidati të mos ketë qene më i vjetër se 30 vite për përgatitjen e punimit të magjistraturës, respektivisht 38 vite për punimin e doktoraturës dhe në ditën e parashtrimit të kërkesës të mos jete mbrojtur punimi i magjistraturës, respektivisht i doktoraturës.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 147/2013):

### **Neni 3**

Hulumtuesit ekzistues detyrohen që të regjistrohen në bazën e të dhënave për hulumtues në vend dhe jashtë vendit (nauka.mk) në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/2014):

### **Neni 4**

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

### **Neni 4**

Akti nënligjorë i përcaktuar me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/2015):

### **Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

### **Neni 6**

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me ligjin me të cilin kanë filluar.

### **Neni 7**

Aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/2016):

### **Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse do të fillojë të zbatohet me fillimin e zbatimit të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative në pajtim me nenin 141 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 124/15).



Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2016):

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/2020):

**Neni 5**

Bashkëpunëtorët e punësuar në institucionet shkencore të cilët, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë fituar shkallë shkencore magjistër, nëse deri më 15 shtator 2025 nuk zgjidhen në titull shkencor, u ndërpritet marrëdhënia e punës.

Bashkëpunëtorët e punësuar në institucionet shkencore të cilët, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë fituar shkallë shkencore magjistër, nëse deri më 15 shtator 2025 nuk zgjidhen në titull shkencor, u ndërpritet marrëdhënia e punës.

Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/2020):

**Neni 6**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut"

Ligj për plotësimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 64/2024):

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Ligj për ndryshimin e Ligjit për veprimtarinë hulumtuese shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/2024):

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi me botimin në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".